



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
REKTORI

Nr. 3134/prot  
/ 4

Tiranë më 2.11.2020

Lënda: Për fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional, afati, kriteret për anëtarët e çdo komisioni dhe dokumentacioni që duhet të dorëzojnë kandidatët

Drejtuar: GJITHË FAKULTETEVE TË UT  
ISE, IFBZ, FILIALI I UT – SARANDË

Bazuar në nenin 46 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 37, 38, 40, 41, 42 dhe 43 të Statutit të Universitetit të Tiranës, si dhe në vendimin nr. 41, datë 21.10.2020 të Senatit Akademik i UT-së, ju njoftojmë për fillimin e procedurave të vetëkandidimit për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional dhe Këshillit të Etikës, konkretisht:

- A. Komisioni i promovimit të personelit akademik;
- B. Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët;
- C. Komisioni i përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë;
- Ç. Komisioni i përhershëm i kurrikulës;
- D. Këshilli i etikës.

A. Bazuar në nenin 38, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i promovimit të personelit akademik**, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 4 të nenit 38 të Statutit të UT-së, anëtarët e Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, duhet të plotësojnë këto kriteret:

1. të jenë pjesë e personelit akademik me kohë të plotë;

2. të mbajë titullin “profesor” dhe të kenë së paku 5 (pesë) vite përvojë në mësimdhënie pas fitimit të këtij titulli;

3. të kenë përvojë pune si anëtar të personelit akademik të paktën 10 vjet;

4. të mos jenë anëtarë të zgjedhur në organet drejtuese.

**B.** Bazuar në nenin 40, pika 1 të Statutit të UT-së, **Komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët**, përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë, pjesë e personelit akademik dhe 3 (tre) anëtarë, përfaqësues të studentëve, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

**C.** Bazuar në nenin 41, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë**, përbëhet nga 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen të paktën nga një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, 1 (një) përfaqësues nga strukturat e sigurimit të cilësisë në Rektorat, 1 (një) përfaqësues nga institutet/degët dhe 3 (tre) përfaqësues të studentëve, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **pjesë e personelit akademik**, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. t’i përkasin kategorisë “Profesor”;

2. të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku 5 vjeçare;

3. të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Bazuar në pikën 2 të nenit 41 të Statutit të UT-së, anëtarët e Komisionit të Përhershëm për sigurimin e standardeve të cilësisë, **përfaqësues i studentëve**, duhet të jetë me notë mesatare të përgjithshme mbi 9.

**Ç.** Bazuar në nenin 42, pika 2 të Statutit të UT-së, **Komisioni i Përhershëm i Kurrikulës**, përbëhet nga 13 (trembëdhjetë) anëtarë, të cilët zgjidhen të paktën nga një përfaqësues nga secili fakultet i UT-së, 2 (dy) përfaqësues nga strukturat ndihmësakadematike me karakter administrativ në aparatet e Rektoratit, 1 (një) përfaqësues nga institutet si dhe 2 (dy) përfaqësues të studentëve, të cilët vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

Bazuar në pikën 2 të nenit 42 të Statutit të UT-së, Anëtarët e Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës, **pjesë e personelit akademik**, duhet të plotësojnë këto kritere:

1. t’i përkasin kategorisë “Profesor”;

2. të kenë përvojë pune si anëtarë të personelit akademik për një periudhë së paku 5 vjeçare;

3. të mos kenë masë disiplinore në fuqi.

Bazuar në pikën 2 të nenit 42 të Statutit të UT-së, Anëtari i Komisionit të Përhershëm të Kurrikulës **përfaqësues i studentëve**, duhet të jetë me notë mesatare të përgjithshme mbi 9.

**D.** Bazuar në nenin 43, pika 2 të Statutit të UT-së, **Këshilli i Etikës**, përbëhet nga 9 (nëntë) anëtarë. 6 (gjashtë) anëtarë i propozohen Senatit Akademik nga Dekanati i secilit fakultet, pjesë e personelit akademik me kohë të plotë. Anëtari i shtatë përzgjidhet nga Senati Akademik midis anëtarëve të tij. Dy anëtarë, nga radhët e studentëve, me mesatare mbi 9, zgjidhen mbi bazën e vetëkandidimit, nga Senati Akademik.

**Periudha e vetëkandidimit** të kandidatëve për anëtarë të Komisioneve të Përhershme në nivel institucional dhe të Këshillit të Etikës, do të jetë nga **data 04 – 11 nëntor 2020, pranë Sekretarisë së Senatit Akademik të UT-së, çdo ditë nga ora 8.00 - 14.00.**



**Dokumentacioni** që duhet të dorëzohet nga kandidatët konkurrentë është si më poshtë:

1. Kërkesë duke specifikuar komisionin për të cilin aplikon;
2. Curriculum Vitae;
3. Kopje të titullit shkencor “Profesor”, “Profesor i Asociuar”;
4. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi;
5. Vërtetim që nuk ka marrë masë disiplinore;
6. Vërtetim që është student (për kandidatët studentë);
7. Listë notash (për kandidatët studentë).

Të merren masat nga ana juaj për njoftimin e personelit akademik me kohë të plotë dhe studentët e fakultetit/institutit/filialit tuaj, duke bërë edhe shpalljen e këtij njoftimi në faqen tuaj *online*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**REKTORI**  
**Prof. Dr. Artan Hoxha**



Adresa: Sheshi “Nënë Tereza”, Rektorati i UT-së, Tiranë, Tel:+355 4 2228402/ Fax: +355 4 223981



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020

**F L E T Ë – A P L I K I M I**  
(për personelin akademik)

**Emër** \_\_\_\_\_

**Mbiemër** \_\_\_\_\_

**Titulli shkencor** \_\_\_\_\_

**Fakulteti/Instituti** \_\_\_\_\_

**Komisioni për të cilin kandidon** \_\_\_\_\_

**Dokumentacioni që dorëzon:** \_\_\_\_\_

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Tiranë më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2020

## FLETË - APLIKIMI

(për studentë)

**Emër** \_\_\_\_\_

**Mbiemër** \_\_\_\_\_

**Fakulteti** \_\_\_\_\_

**Komisioni për të cilin kandidon** \_\_\_\_\_

**Dokumentacioni që dorëzon:** \_\_\_\_\_

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_